



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.27

Prishtinë, më 2.12.2015, në orën: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi dhe Alma Lama.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Jelena Bontiq dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: KPM-së, RTK-së, KPMSHCK-së, GAP-it, NDI-së, KDI-së dhe RTV21.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me organet e pavarura të cilat bien në fushëveprimtarinë e Komisionit, lidhur me kërkesat e tyre buxhetore për vitin vijues;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim me organet e pavarura të cilat bien në fushëveprimtarinë e Komisionit, lidhur me kërkesat e tyre buxhetore për vitin vijues;

Zenun Pajaziti njoftoi anëtarët e komisionit për analizën buxhetore për vitin 2016, të hartuar nga NDI-ja, në bashkëpunim me Institutin GAP.

Ndërsa, duke i njoftuar përfaqësuesit e KPM-së, RTK-së dhe KPMSHCK-së, për arsyen e ftesës tha se shqyrtimi i Projektbuxhetit bie në fushëveprimin e Komisionit Parlamentar për Buxhet e Financa.

Ne si Komision FunkSIONAL kemi marrë qëndrim që t'ju ftojme për t'ju dëgjuar rreth kërkesave dhe nevojave buxhetore të organeve të pavarura dhe në anën tjetër mundësive shtetërore për buxhetin, me idenë që vitin e ardhshëm, komisioni do të bazohet në këto analiza buxhetore, si orientim, duke rekrutuar staf për hulumtime buxhetore, të cilët i ndihmojnë komisioneve për mënyrën e shpenzimeve buxhetore të organeve të pavarura dhe planifikimet buxhetore, theksoi Pajaziti .

Adnan Merovci, kryetar i KPM-së, tha se Komisioni i Pavarur për Media, si kategori kushtetuese për kërkesat e veta i drejtohet Kuvendit dhe në këtë kontekst edhe për kërkesat buxhetore. Është krijuar një përshtypje që KPM-ja nuk prodhon asgjë dhe ka pak shpenzime, për informacion ka shpenzime ndër të tjera edhe për hartimin e akteve nënligjore, KPM-ja nga punët e kryera në kuadër të fushëveprimit të vet, do ta siguronte edhe vet ekzistencën, por kjo është e ndaluar me ligj. Me ndryshimet në tregun medial, është rritur vëllimi i aktiviteteve, zhvillimet teknologjike, digjitalizimi, e tjera.

KPM-ja, është në një situatë të rëndë financiare. Me Projektligjin e buxhetit për vitin 2016, KPM-së i është ndarë 32% nga kërkesa e KPM-së për nevoja buxhetore për vitin 2016, tha Merovci.

Mimoza Pllana, anëtare e Bordit të RTK-së, tha se transmetuesi publik është para aktit të kryer, lidhur me ndarjen e buxhetit për vitin 2016.

Ajo kërkoi që Kuvendi si themelues i RTK-së, të gjejë zgjidhjen afatgjate për financimin e RTK-së, duke i marrë parasysh edhe propozimet që RTK-ja i ka adresuar në Kuvend për financimin e RTK-së, e që për arsye ende të panjohura për RTK-në është prolonguar zgjidhja e qëndrueshme e financimit të RTK-së.

Zenun Pajaziti, duke ju drejtuar përfaqësuesve të RTK-së, kërkoi nga ata që të veprojnë mbi bazën e rekomandimeve që Kuvendi i ka nxjerr për RTK-në.

Lulzim Aliaj, kryetar i KPMSHCK-së, duke vlerësuar iniciativën, bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen e komisionit për kërkesat e organeve të pavarura, tha se KPMSHCK, si institucion kushtetues për mbikëqyrjen e gjithë shërbyesve civilë në Kosovë, po përballlet me vështirësi për funksionim, në mungesë të sallave për takime me palët, mungesë të stafit.

Këshilli po mundohet që çdo ankesë të trajtojë konform ligjit, duke mos i dëmtuar interesat e institucioneve, të nëpunësve dhe interesat e shtetit.

Xhevahire Izmaku, tha se kjo iniciativë është një praktikë e re edhe pse komisioni në bazë të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura është i njoftuar me gjendjen financiare të këtyre institucioneve si organizata buxhetore të ndara.

Për KPMSHCK-në, kërkesat financiare të mungesës së hapësirave për mbledhje, komisioni e ka përcjellë kërkesën në adresën e duhur. Sa i përket ndarjes së mjeteve financiare nga IPA-ja, për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, në krahasim me kërkesat e KPMSHCK, ndarja është joproporcionale, duke pasur parasysh rëndësinë e funksionimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Ndërsa sa i përket propozimeve që RTK-ja i ka adresuar Kuvendit, është dashur të jetë një vullnet më i reflektuar dhe partneriteti si nga bordi ashtu edhe menaxhmenti i RTK-së, jo vetëm me komisionin por edhe me Kuvendin, duke fuqizuar komunikimin.

Tek çështja e KPM-së, numri i operatorëve të cilët bien në menaxhimin e KPM-së është rritur, ndërsa buxheti është i njëjtë. Në kontekst të kësaj, Izmaku tha se ka paqartësi për realizimin e digjitalizimit.

Alma Lama, i propozoi përfaqësuesit të KPM-së, që të paraqesin në komision me një parallogaritje kërkesat e tyre buxhetore, duke përfshirë edhe shpenzimet për hartimin e rregulloreve, në mënyrë që komisioni pastaj do të mund të propozonte amendament gjatë shqyrtimit të dytë të Projektligjit për buxhetin e vitit 2016.

Sa i përket KPMSHCK-së, Lama u pajtua me kërkesat e tyre për kushte më të mira për funksionimin e këshillit.

Duke iu drejtuar përfaqësuesve të RTK-së, ajo tha se sa i përket kërkesave të RTK-së, fillimisht duhet që RTK-ja të jap llogaridhënie për buxhetin në kontekstin se si RTK-ja ka planifikuar ti shpenzojë shumën e ndarë me Projektligjin për buxhetin e vitit 2016, e pastaj të paraqesin kërkesa të justifikuara para komisionit. Ajo gjithashtu, kërkoi sqarim nga përfaqësuesit e RTK-së për shpërdorimet e parasë publike, duke ju referuar një shkresë që një anëtar i Bordit të RTK-së e kishte adresuar në komision. Gjithashtu kërkoi sqarime për numrin e të punësuarve dhe pse vetëm rreth 8 % nga buxheti i RTK-së, është ndarë për projekte kapitale.

Sadri Ferati, tha se si çështje për diskutim është çështja e modelit të participimit lidhur me financimin e RTK-së, por se ende nuk ka ndonjë marrëveshje me asnjë institucion për zgjidhjen e problemit, ndërsa financimi nga shteti nuk është variant më i mirë.

Sa i përket këshillit, i arsyetoi kërkesat e tyre të parashtruara dhe rekomandoi që organet e pavarura të jenë më racionale rreth shpenzimeve buxhetore.

Zenun Pajaziti, tha se i inkurajon organet e pavarura në periudhën vijuese që t'i adresojnë çështjet si rekomandime për Kuvendin dhe u zotua se komisioni do të përshpejtojë procedimin e plotësim ndryshimit të Ligjit për RTK-në.

3. Të ndryshme.

Pasi për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.
Mbledhja përfundoi në orën: 12:30.

E përgatiti :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti
